



Qëndresa Qytetare: 85% e qytetarëve të Tiranës e blejnë ujin e pijshëm në market
Rreth 75 % e banorëve nuk furnizohen 24 orë me ujë të pijshëm
Privatizimi i UK-Tiranë: 75 % e qytetarëve i thonë JO

Grupimi “Qëndresa Qytetare” ka zhvilluar një anketim online lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm në Bashkinë e Tiranës. Ky anketim vjen pas ankesave të shumta drejtuar UK-Tiranë dhe debatit publik për privatizimin e tij. Nga anketimi rezulton se 98 % e qytetarëve tashmë e paguajnë faturën e ujit të pijshëm por kjo nuk mjafton që UK-Tiranë t’ju sigurojë atyre ujë cilësor sipas standarteve të BE dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, pasi vetëm 30 % e qytetarëve e përdorin ujin që paguajnë në faturën e UK për të gatuar dhe vetëm 15 % e përdorin për ujë të pijshëm, ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve (85%) e blejnë në market për shkak të ndotjes, erës së rëndë dhe mungesës së standarteve minimale të higjienës.

A e paguani rregullisht faturën e ujit të pijshëm? (221 responses)




A e përdorni për ujë të pijshëm dhe gatim në familjen tuaj ujin e Ujësjellës – Kanalizime Tiranë? (221 responses)




Sipas anketimit të Qëndresës Qytetare vetëm 25 % e banorëve furnizohen me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerje ndërsa 75 % furnizohen me orare gjatë ditës. Jo vetëm mungesa e cilësisë, por edhe mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm në vendin me rezervat më të larta në Europë (rreth 600 litër/frymë) përbën paradoksin e madh dhe nxjerr në pah mungesën e menaxhimit të burimeve hidrike në Shqipëri.

Furnizimi me ujë të pijshëm në shtëpinë apo apartamentin ku banoni është... (219 responses)





A e blini ujin e pijshëm në market? (220 responses)



Sa i përket debatit të fundit publik mbi mundësinë e privatizimit të UK-Tiranë, Qëndresa Qytetare i pyeti banorët e Bashkisë Tiranë nëse janë pro apo kundër privatizimit. Nga anketimi 221 banorëve të Bashkisë Tiranë, vetëm 25 % ishin pro privatizimit të UK-Tiranë, ndërsa pjesa tjetër kundër. Ky rezultat tregon barrën e përgjegjësishë që qytetarët e Tiranës I kanë besuar bashkisë nëpërmjet votës për të përmirësuar sistemin e ujësjellës kanalizimeve dhe cilësinë e ujit sipas premtive elektorale dhe mungesën e besueshmërisë tek një privat i tretë.

Mendoni se uji i pijshëm që ju furnizohet nga kontrata me UK- Tiranë është... (214 responses)

A jeni dakort që UK Tiranë të privatizohet? (211 responses)



Për të parë rezultatin e anketimit të kohë reale klikoni në linkun:

<https://docs.google.com/forms/d/1qanqqiyVqmqz43YphMnCurIDycqzqzvKFqalH-CuUwJ8/edit#responses>

www.qendresaqytetare.al

qendresaqytetare@gmail.com

Tel: 0692203074